



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1597/1 Prot.

Tiranë, më 13 / 11 / 2018

V E N D I M

Nr. 228 , Datë 13 / 11 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr. 127, datë 29.08.2018 të paraqitur nga F.P kundër Universitetit të Arteve Tiranë (UART) në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “etnisë¹” dhe “gjendjes ekonomike²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se ka filluar studimet në vitin akademik 2017-2018 dhe ka përfunduar vitin e parë në degën Pedagogji Muzikore pranë Fakultetit të Muzikës të Universitetit të Arteve Tiranë. Ankuesi informon se bazuar në VKM nr.269, datë 23.09.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, në muajin Mars 2018 ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar nga Universiteti, brenda afatit të caktuar për të përfituar përjashtimin nga tarifa vjetore e studimit, pasi i përket komunitetit egjiptian të Shqipërisë. Nga sekretaria mësimore është njoftuar verbalisht se nuk është miratuar kërkesa e tij me arsyetimin se në formularin e regjistrimit fillestar

¹Referuar vërtetimit datë 30.08.2018 të lëshuar nga organizata “Lëvizja Rinore-Egjiptiane&Rome”, subjekti ankues i përket komunitetit Egjiptian të Shqipërisë.

- Referuar Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 “Diskriminim racialet është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë që bazohet se shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, që justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash”.

² Familja e F.P përbëhet nga dy prindërit dhe 3 fëmijë. Referuar Vërtetimit nr.550, datë 04.09.2018 të lëshuar nga Bashkia Elbasan, Agjencia e Shërbimeve Publike, A.P (nëna) ka pagën mujore bruto në vlerën 30.000 lekë.

nuk ka plotësuar se i përket komunitetit egjiptian. F.P informon se për këtë shkak nuk lejohet të marrë pjesë në provimet e sesionit të vjeshtës, duke i cënuar të drejtën për ndjekjen e studimeve.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, përjashtimin nga tarifa e studimit dhe trajtimin me përparësi të rastit në mënyrë që ti mundësohet pjesëmarrja në provimet e sesionit të vjeshtës.

Ankesa e sjellë pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, lidhur me shpjegimet e dhëna për shkakun e pretenduar prej subjektit ankues.

- Për këtë arsye, me e-mail-in datë 31.08.2018, inspektori i çështjes, ka kërkuar nga subjekti ankues, informacion lidhur me ankesën dhe dokumentacion për të provuar gjendjen ekonomike.
- Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, subjekti ankues me e-mail-in datë 03.09.2018 ka dërguar pranë Komisionerit informacion dhe dokumentacion shtesë lidhur me pretendimin e tij.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Bazuar në nenin 33/4 të ligjit Nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesa e paraqitur nga subjekti ankues, është e vlefshme nga pikëpamja formale pasi nuk ekziston asnjë nga rastet përjashtuese të parashikuara në këtë nen, që do ta bënte këtë ankesë të papranueshme. Si pasojë ankesa iu nënshtua shqyrtimit të plotë.

³ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- A. Me shkresën nr.1178/1, datë 30.08.2018 është bërë njoftimi i Universitetit të Arteve në lidhje me pretendimin për diskriminim të paraqitur nga ankuesi si dhe i është kërkuar Universitetit të Arteve që ti lejohet studentit F.P pjesëmarrja në sesionin e provimeve të vjeshtës deri në përfundim të shqyrtimit e ankesës nga ana e Komisionerit.

Me shkresën nr. 1040/1, datë 04.09.2018, Universiteti i Arteve, ka informuar Komisionerin se: *“Në zbatim të VKM nr.269, datë 23.09.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, si dhe Kreut VI/2 të Udhëzimit të MASR nr.15, datë 19.05.2017 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2017-2018” i ndryshuar, është nxjerrë urdhri i Rektorit nr.2, datë 14.02.2018 “Mbi ngritjen e grupit të punës për pranimin e aplikimeve të studentëve, të cilët përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2017-2018, në UART”. Një ndër detyrat e grupit të punës, pika 6 ka qenë grumbullimi i dokumentacionit të paraqitur nga studentët e UART dhe përgatitja e informacionit drejtuar Administratores së Universitetit të Arteve, për të kaluar për miratim në Bordin e Administrimit të UART. Me shkresën nr.340, datë 03.05.2018 grupi i punës ka përgatitur materialin përfundimtar dhe ia ka dërguar Administratores së UART në lidhje me studentët të cilët përfitojnë ose jo përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit për secilin Fakultet të UART. Më pas ky material i është përcjellë për miratim Bordit të Administrimit, i cili me Vendimin nr.07, datë 21.05.2018, ka miratuar studentët që përfitojnë përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit për secilin Fakultet të UART. Në pikën 4 të relacionit shoqërues të vendimit të bordit, përcaktohen studentët të cilët nuk përfitojnë përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit. Gjithsej në UART janë 5 studentë dhe njëri prej tyre është F.P. Kjo vendimmarrje është mbështetur në Kreun VI/2 të Udhëzimit të MASR nr.15, datë 19.05.2017 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2017-2018” i ndryshuar me Udhëzimin nr.18, datë 16.08.2017, ku citohet se: 1.”Kandidatët nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Macedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian, të aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë (IAL), nga data 21-26 Gusht 2017, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL.....”. Këta studentë ku përfshihet dhe F.P, nuk kanë përfutuar përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, pasi nuk kanë konkuruar në kuotat përkatëse të parashikuara nga UART, (në rastin e F.P, në kuotat e kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian)”.*

Gjithashtu, Universiteti i Arteve informon Komisionerin se shkak për mos pranim në futjen e sesionit të vjeshtës të studentit F.P, është se nuk ka paguar tarifën vjetore të shkollimit, por duke marrë në konsideratë kërkesën e Komisionerit, Universiteti i Arteve ka vendosur që studentit F.P të ketë një afat kohor për tu regjistruar në sesionin e vjeshtës deri në datën 20.09.2018.

B. Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr. 161, datë 06.09.2018 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për kryerjen e inspektimit në Universitetin e Arteve”, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë këtij institucioni, me datë 11.09.2018, për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit pranë Universitetin e Arteve, inspektorët e KMD-s, morën takim me E.P, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Informacionit dhe T.K me detyrë, Specialist në Sektorin Juridik.

Gjatë inspektimit, E.P dhe T.K në mes të tjerash deklaruan se: *“Mos përjashtimi nga tarifa e studimit për studentin F.P për vitin akademik 2017-2018 është bërë për shkak se Udhëzimi nr.15, datë 19.05.2017 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2017-2018” i ndryshuar me Udhëzimin nr.18, datë 16.08.2017, Kreu VI/2, ka përjashtuar kandidatët e komunitetit rom/egjiptian që nuk kanë konkuruar me kuotat përkatëse nga përjashtimi i tarifës së studimit. Deri në vitin akademik 2017-2018 të gjithë studentët që kanë qenë nga komuniteti rom/egjiptian janë përjashtuar nga tarifat e studimit pavarësisht mënyrës së konkurimit me kuota apo jo. Studentët e vitit të II-të dhe të III-të që janë anëtarë të komunitetit rom/egjiptian pavarësisht konkurimit apo jo me kuota janë përjashtuar nga tarifa e studimit. Mos përjashtimi nga tarifa e studimit është bërë vetëm për studentët e komunitetit rom/egjiptian dhe PAK të vitit të I-rë që ishin prekur nga udhëzimi i sipërcituar”.*

C. Me shkresën nr.1178/5, datë 14.09.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kërkuar nga Universiteti i Arteve që studentit F.P ti lejohej pjesëmarrja në sesionin e provimeve të vjeshtës deri në përfundim të shqyrtimit të ankesës nga ana e Komisionerit.

Me shkresën nr.1119/1, datë 18.09.2018, Universiteti i Arteve ka informuar Komisionerin se studentit F.P është regjistruar, pranë Fakultetit të Muzikës, për të marrë pjesë në sesionin e provimeve të vjeshtës.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë dhe të disfavorshëm të ankuesit nga Universiteti i Arteve.

Mbështetur në aktet e administruara gjatë procesit të shqyrtimit administrativ të ankesës së shtetasit F.P, rezulton se ankuesi pas zhvillimit të konkursit të pranimit për vitin akademik 2017-2018 është shpallur fitues dhe është regjistruar si student i vitit të I-rë, në degën Pedagogji Muzikore, pranë Fakultetit të Muzikës të Universitetit të Arteve.

Në periudhën, Mars 2018 ka dorëzuar dokumentacionin për të përfituar përjashtimin nga tarifa vjetore e studimit, pasi i përket komunitetit egjiptian të Shqipërisë.

Bordi i Administrimit të UART, me Vendimin nr.07, datë 21.05.2018, ka miratuar studentët që përfitojnë dhe nuk përfitojnë përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit për secilin Fakultet të UART. Në pikën 4 të relacionit shoqërues të vendimit të sipërcituar është përcaktuar se studenti F.P, bazuar në VKM-s nr.269, datë 23.09.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” dhe Udhëzimit nr.15, datë 19.05.2017 të MASR “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018” i ndryshuar, **nuk përfiton përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, pasi nuk ka konkuruar në kuotat e parashikuara për kandidatët e komunitetit rom dhe egjiptian.**

Neni 4, i ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” përcakton se shteti garanton arsimimin për individët që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, por që nuk kanë mundësitë financiare për t’i përballuar ato. Në këto programe studimi, u garantohej arsimimi edhe individëve, të cilëve u njihet kjo e drejtë me ligje të veçanta.

Përcaktimi i kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit dhe që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2017-2018 është rregulluar sipas VKM-s nr.269, datë 23.09.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”. Në pikën 1/e të kësaj VKM-je përcaktohet shprehimisht se: “1. Përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit studentët të cilët janë pranuar në një program të ciklit të parë të studimeve.....në institucionet publike të arsimit të lartë, të kategorive të mëposhtme: e) *Studentët romë dhe ballkano-egjiptianë, të konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për mirëqënien sociale*”.

Kuotat dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2016-2017 janë rregulluar sipas VKM nr. 866, datë 23.10.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 638, datë 22.07.2015 “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve të ciklit të parë, programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015-2016”. Në pikën 4 të kësaj VKM-je përcaktohet shprehimisht se: “*Studentët të cilët vijnë nga shtresa sociale, sipas përcaktimeve në shtojcën⁴ 1/2 bashkëlidhur këtij vendimi, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit në të gjitha programet e studimeve të ciklit të parë “Bachelor”, programet e*

⁴ Personat që nuk shikojnë/dëgjojnë; invalidët e punës dhe fëmijët e tyre; invalidët; invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe fëmijët e tyre; jetimët; romët; ballkano-egjiptianët; etj.

studimeve jouniversitare profesionale dhe programet e integruara të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, me formë studimi me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë”.

Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018 janë rregulluar sipas Udhëzimit nr.15, datë 19.05.2017 të MASR “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018” i ndryshuar me Udhëzimin nr.18, datë 16.08.2017, në të cilin përcaktohet se: VI/2, 1. *“Kandidatët nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Macedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian, të aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë (IAL), nga data 21-26 Gusht 2017, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL.....”.*

Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016-2017 janë rregulluar sipas Udhëzimit nr.18, datë 11.08.2016 të MAS “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatë më origjinë shqiptare nga Macedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, si dhe kandidatëve me statusin e të verbrit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të jetimit, si dhe romët dhe egjiptianët, në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016-2017” në të cilin në pikën 1 përcaktohet se: *“Kandidatët nga Republika e Kosovës, kandidatë më origjinë shqiptare nga Macedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, si dhe kandidatët me statusin e të verbrit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, e jetimit, romët dhe egjiptianët, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, nga data 12-19 Gusht 2016 në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL.....”.*

Referuar legjislacionit të sipërcituar, vlerësohet se nuk ka patur ndryshim të legjislacionit për sa i përket kategorive që përfitojnë përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, pasi si në VKM nr. 866, datë 23.10.2015 ashtu dhe në VKM nr. 269, datë 29.3.2018 studentët romë dhe ballkano-egjiptian përfitojnë përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit pavarësisht konkurimit nëpërmjet kuotave apo jo.

Gjithashtu, në vlerësim të udhëzimeve të MASR për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit të kandidatëve për vitin akademik 2016-2017 dhe 2017-2018 nuk përcaktohet ndonjë ndryshim në drejtim të mospërjashtimit nga pagesa e tarifave vjetore të shkollimit pasi këto udhëzime rregullojnë procedurat e aplikimit dhe regjistrimit të kandidatëve dhe nuk përcaktojnë kategoritë e individëve që përjashtohen apo jo nga tarifa vjetore e shkollimit.

Me Urdhrin nr.2, datë 14.02.2018, “Mbi ngritjen e grupit të punës për pranimin e aplikimeve të studentëve, të cilët përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2017-2018”

Universiteti i Arteve ka ngritur grupin e punës të përbërë nga, E.P, T.K dhe J.Sh të cilët kishin për detyrë pranimin e aplikimeve të studentëve dhe përgatitjen e informacionit për Administratorin e Universitetit, për miratim në Bordin e Administrimit.

Bordi i Administrimit pas diskutimit të relacionit të paraqitur nga Administratori i UART-s me Vendimin nr.7, datë 21.05.2018 ka vendosur përjashtimin dhe mospërjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve sipas relacionit të përgatitur nga grupi i punës. Në pikën 1 të relacionit të këtij vendimi, rezulton se në Fakultetin e Muzikës kanë përfituar përjashtimin nga tarifa 33 studentë të ciklit të studimeve Bachelor, të ndarë sipas viteve si më poshtë: **Në vitin e parë** kanë përfituar 6 studentë të ndarë sipas kategorive: 3 studentë me aftësi të kufizuara, 2 studentë familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 1 student që i përket kategorisë rom dhe ballkano-egjiptian. **Në vitin e dytë** kanë përfituar 15 studentë të ndarë sipas kategorive: 4 studentë me aftësi të kufizuara, 2 studentë familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 9 studentë që i përkasin kategorisë rom dhe ballkano-egjiptian. **Në vitin e tretë** kanë përfituar 12 studentë të ndarë sipas kategorive: 3 studentë me aftësi të kufizuara, 3 studentë familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 4 studentë që i përkasin kategorisë rom dhe ballkano-egjiptian dhe 2 studentë të shkëlqyer që rezultojnë me notën mesatare vjetore 10, për studentët e regjistruar në vitet pas të parit.

Në pikën 4 të relacionit të sipërcituar rezulton se Universitetin e Arteve nuk janë përjashtuar nga tarifa e studimeve 5 studentë të vitit të parë të studimeve që i përkasin kategorive si më poshtë: 2 studentë me aftësi të kufizuara të Fakultetit të Arteve të Bukura dhe 3 studentë që i përkasin kategorisë, rom dhe ballkano-egjiptian, 2 që i përkasin Fakultetit të Muzikës dhe 1 Fakultetit të Arteve të Bukura, një ndër këto studentë është dhe ankuesi F.P. Sipas arsyetimit që ka agrumtuar grupi i punës rezulton se këto studentë nuk kanë përfituar pasi nuk kanë konkuruar për vitin akademik 2017-2018 sipas Kreut VI/2 të Udhëzimit nr.15, datë 19.05.2017 të MASR *“Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018”* i ndryshuar me Udhëzimin nr.18, datë 16.08.2017, ku citohet se: VI/2, 1. *“Kandidatët nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Macedonia, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të komunitetit rom dhe egjiptian, të aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë (IAL), nga data 21-26 Gusht 2017, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL.....”*.

Në vlerësim të dokumenteve të sipërcituar por dhe referuar deklarimeve⁵ të dy anëtarëve të grupit të punës së UART, provohet se vetëm studentët e vitit të parë, 2017-2018 që i përkasin kategorive që përcaktohen në pikën 1 të VKM nr.269, datë 23.09.2017 dhe që kanë fituar të drejtën e

⁵ Referuar procesverbalit të inspektimit datë 11.09.2018 *“Studentët e vitit të II-të dhe të III-të që janë anëtarë të komunitetit rom/egjiptian pavarësisht konkurimit apo jo me kuota janë përjashtuar nga tarifa e studimit. Mos përjashtimi nga tarifa e studimit është bërë vetëm për studentët e komunitetit rom/egjiptian dhe PAK të vitit të I-rë që ishin prekur nga Udhëzimi nr.15, datë 19.05.2017”*, i ndryshuar.

studimit nëpërmjet konkursit nuk kanë përfituar nga përjashtimi i tarifës së studimit ndërkohë që vitin e kaluar studentët që i përkisnin kategorive që përcaktohen në pikën 1 të VKM nr.269, datë 23.09.2017 kishin përfituar përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit.

Sikurse shihet qartazi, VKM 866/2016 dhe VKM 269/2018 i trajton në mënyrë të padifenencur dhe të njëjlojtë, sa i takon përjashtimit nga tarifa vjetore e shkollimit për studentët nga komunitetit rom dhe ballkano-egjiptian, ndërkohë që Bordi i Administrimit të Universitetit të Arteve ka mbajtur qëndrim të ndryshëm për studentët e komunitetit rom dhe ballkano-egjiptian të cilët përfitonin përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit për vitet akademike 2016-2017 dhe 2017-2018 duke përjashtuar nga përfitimi i mospagimit të tarifës studentët e komunitetit rom dhe ballkano-egjiptian që kanë fituar konkursin për pranimin në UART për vitin 2017-2018.

Në vlerësim të dokumenteve të administruara, mbi përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit për studentët nga komunitetit rom dhe ballkano-egjiptian, Komisioneri konstaton se interpretimi i bërë nga Bordi i Administrimit të Universitetit të Arteve, për mospërjashtimin e kësaj kategorie ka bërë që studenti F.P të trajtohet në mënyrë të pafavorshme në raport me përfitimet që parashikon legjislacioni i sipërcituar.

Në përfundim, referuar nenit 7/1, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁶, Komisioneri gjykon se studenti F.P i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, nga ana e Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve Tiranë.

B. Shkaku i mbrojtur.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkak të parashikuara në ligj, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Për të vërtetuar se ndaj subjektit ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e Universitetit të Arteve Tiranë, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe trajtimit të pafavorshëm të ankuesit.

Pretendimi i F.P se shkak për diskriminim ndaj tij është bërë “etnia”⁷ përbën shkak që gëzon mbrojtje sipas nenit 1 të ligjit 10221/2010, pasi nga shqyrtimi i dokumenteve nga Komisioneri, rezulton se F.P është anëtar i komunitetit egjiptian të Shqipërisë.

Lidhur me pretendimin e F.P për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike”⁸, Komisioneri vlerëson se ankuesi nuk vuri në dispozicion të Komisionerit dokumente dhe prova për të vërtetuar

⁶ Neni 7, pika 1, i ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi parashikon: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

⁷ Referuar vërtetimit datë 30.08.2018 të lëshuar nga organizata “Lëvizja Rinore-Egjiptiane&Rome”, subjekti ankues i përket komunitetit Egjiptian të Shqipërisë.

⁸ Referuar Vërtetimit nr.550, datë 04.09.2018 të lëshuar nga Bashkia Elbasan, Agjencia e Shërbimeve Publike, A.P (nëna) ka pagën mujore bruto në vlerën 30.000 lekë.

përbërjen familjare, gjendjen ekonomike të familjes së tij dhe se të ardhurat mujore të familjes sigurohen vetëm nga paga e nënës së tij.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

C. Lidhja e trajtimit të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 1, të tij rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me etninë,.....ose çdo shkak tjetër” dhe qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike, në qasje me sa parashikohet prej tij.

Mbështetur në parashikimet e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, konkretisht të nenit 3/1: *“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Për të vërtetuar se ndaj subjektit ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e Universitetit të Arteve Tiranë, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe trajtimit të pafavorshëm të ankuesit.

Në një vlerësim të përgjithshëm, Komisioneri vëren se referuar pikës 1/e të VKM-s nr.269, datë 23.09.2017 studentët e komunitetit ballkano-egjiptian janë përcaktuar si një ndër kategoritë përfituese për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit pavarësisht kuotave të pranimit, dhe kjo masë është marrë nga ana e Këshillit të Ministrave sidomos për kategoritë në nevojë dhe komunitetet që janë më pak të avantazuara.

Në nenin 7 të Konventës Ndërkombëtare për Eleminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial (CERD) të miratuar nga shteti Shqiptar nëpërmjet Ligjit nr.7768, datë 09.11.1993 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën ndërkombëtare për zhdukjen e të gjitha formave të dallimit racor” përcaktohet se: *“Shtetet palë zotohen të marrin masa të menjëhershme dhe efektive sidomos në fushën e arsimit, edukimit, kulturës dhe informacionit për të luftuar kundër paragjykimeve që çojnë drejt diskriminimit racial dhe për të ndihmuar mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis kombeve dhe grupeve racore ose etnike, si dhe për të propaganduar qëllimin dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, të Deklaratës Universale*

për të Drejtat e Njeriut, të Deklaratës së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit Racial të kësaj Konvente”.

Referuar Komisionit të OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit Racor, për të qenë i lejueshëm, qëllimi i vetëm i masave pozitive të ndërmarrja duhet të jetë eliminimi i pabarazive ekzistuese dhe parandalimi i pabarazive të ardhshme⁹. Shtetet Palë duhet të edukojnë dhe të rrisin ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e masave të posaçme për të trajtuar situatën e viktimave të diskriminimit racial, veçanërisht të diskriminimit si rezultat i faktorëve historikë.

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit Racor (CERD) thekson se trajtimi në mënyrë të barabartë i personave ose grupeve, situatat e të cilave janë objektivisht të ndryshme, në fakt, do të përbëjnë diskriminim.

Sipas KEDNJ-së, një shtet mund t'u nënshtrohet detyrimeve pozitive. Praktika relevante e GJEDNJ-së për veprimet pozitive kryesisht i kushtohet çështjes nëse në situata të caktuara shteti është i detyruar, dhe jo vetëm i lejuar, të ndërmarrë veprime pozitive¹⁰.

Në çështjen Thlimmenos kundër Greqisë¹¹, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka mbajtur qëndrimin se: “.....kemi një diskriminim kur shteti pa një argumentim objektiv dhe racional e refuzon trajtimin e diferencuar të personave, situata e të cilëve është tepër e ndryshme.....”.

Në çështjen Horvath dhe Kiss kundër Hungarisë¹², një rast në lidhje me vendosjen e fëmijëve romë në shkolla të veçanta, GJEDNJ theksoi se shteti kishte detyrime pozitive për të ndrequr një histori të segregimit racor në shkolla. GJEDNJ gjithashtu vuri në dukje se shteti kishte detyrime specifike pozitive për të shmangur vazhdimin e diskriminimit të kaluar ose praktikat diskriminuese të maskuara në testimet e dyshuara neutrale.

Neni 11, i LMD-së ka parashikuar dhe mundësinë e ndërmarrjes së një sërë masash pozitive, duke sanksionuar se: “Masa e përkohshme, e veçantë që synon përshtetjen e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendur në nenin 1, të këtij ligji, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, sipas këtij ligji. Kjo masë ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta”. Pra veprimet pozitive që ka ndërmarrë qeveria e Republikës së Shqipërisë nuk janë një përjashtim nga parimi i mosdiskriminimit, por janë pjesë integrale e kuptimit dhe janë thelbësorë për eliminimin e diskriminimit racor, përparimin e dinjitetit njerëzor dhe barazisë efektive dhe të mosveçimit të kategorive të paavantazuara dhe të personave vulnerabël.

Në kushtet kur mospasja e arsimit, është një nga faktorët që ndikon në mosintegrimin e këtyre komuniteteve në shoqëri, institucionet publike arsimore dhe sidomos institucionet e arsimit të lartë publik duhet të tregohen më të hapur dhe të predispozuar në arsimimin e qytetarëve që i

⁹ Handbook on European non-discrimination law, 2018 edition, faqe 72.

¹⁰ Handbook on European non-discrimination law, 2018 edition, faqe 77.

¹¹ Thlimmenos kundër Greqisë, Kërkesa nr. 34369/97, vendimi me datë 06.04.2000.

¹² ECtHR, Horvath dhe Kiss kundër Hungarisë, Nr.11146/11, 29.01.2013.

përkasin këtyre pakicave. Formimi i të rinjve të komunitetit rom dhe egjiptian me arsim të lartë, ndikon drejtpërdrejtë në jetën e komuniteteve të tyre dhe ndihmon në përshpejtimin e integritit të tyre shoqëror e kulturor në shoqërinë shqiptare.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është i mendimit se UART nuk ka dhënë një shpjegim të arsyeshëm dhe objektiv në lidhje me mospërjashtimin e studentit F.P nga tarifa e shkollimit.

Në këtë kuadër, Komisioneri, konstaton se studenti F.P, si anëtar i komunitetit egjiptian të Shqipërisë, i cili sipas përcaktimeve të pikës 1/e të VKM-s nr.269, datë 23.09.2017, duhet të rezultonte përfitues për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, është vënë në pozita jo të favorshme në përputhje me parashikimet e vetë kësaj VKM-je, duke ia mohuar atij mundësinë për të përfituar nga përjashtimi i pagesës së tarifës së shkollimit. Pra, studenti F.P është vënë në pozita përjashtuese dhe diskriminuese, pikërisht për shkak të etnisë së tij.

Në përfundim për gjithë sa më sipër, Komisioneri konstaton se, kemi trajtim të papërligjur, jo objektiv dhe të pajustificuar në argumente, të studentit F.P që i përket kategorisë së listuar në pikën 1 të VKM nr.269, datë 29.03.2017, sa i takon përjashtimit nga pagesa e tarifës vjetore të shkollimit. Mosmiratimi i aplikimit të F.P për përjashtimin nga tarifa vjetore e studimit nga ana e Bordit të Administrimit, përbën një ushtrim arbitrar të veprimtarisë administrative, në kundërshtim me Kushtetutën¹³ dhe në shkelje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në përfundim, Komisioneri, vlerëson se marrja e masave nga ana e Universitetit të Arteve dhe Bordit të Administrimit, duke përjashtuar studentin F.P, nga pagesa e tarifës vjetore të shkollimit, do të ndikonte në përmirësimin e kësaj situatë, dhe do i shërbente në mënyrë të drejtpërdrejtë eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit dhe të veçimit të kategorive të paavantazuara dhe të personave vulnerabël.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të shtetasit F.P nga ana e Universitetit të Arteve Tiranë dhe

¹³ Neni 18 “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive”.

Bordit të Administrimit për shkak të etnisë.

2. Në referim të pikës 1, Universiteti i Arteve Tiranë dhe Bordi i Administrimit, si subjekte që kanë konsumuar sjelljen diskriminuese, të marrin masa për përjashtimin ose rimbursimin e studentit F.P nga pagesa e tarifës vjetore të shkollimit.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Universiteti i Arteve Tiranë, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojnë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA